



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 23.07.2024

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 23.07.2024 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e VII-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **29.07.2024**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 6-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024.
2. Pyetje legjislativiteti drejtuar ekzekutivit.
3. Raporti i punës së Kryetarit për periudhën gjashtëmujore 01.01.2024-30.06.2024.
4. Raporti Tremujor Financiar Prill-Qershor 2024.
5. Informatë rreth aktiviteteve të KKS-së për (gjashtëmujorin) e parë të vitit 2024.
6. Raporti i Audimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2023.
7. Kërkesë nga MAPL-ja nr.04/5685, për harmonizimin e Vendimit nr.21038.
8. Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve.
9. Të ndryshme.



Kryesuesi i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOS. QENDRA PER SHERBIM TE QY CENTAR ZA USLUGU GRAHANA	
Sh. <u>01</u>	Nr. <u>23291</u>
U. <u>01</u>	Br. <u>01</u>
Nr. i faq. <u>10</u>	Data: <u>22/07</u>
Br. str. <u>01</u>	Datum: <u>2024</u>

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe mbajtur më: 21.06.2024 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të Zyrës për Integrim Evropian, OJQ dhe OSBE. Mbledhjen e hapì dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 5-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,
2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), për Komunën e Kamenicës për vitin 2025-2027,
4. Propozim-Vendim për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2026,
5. Propozim-Vendim për miratim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për " Qëndresa Gagica Hajdari B.I" me procedurë të negocimit të ofertës,
6. Propozim-Vendim për miratim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për " Vetem Kallaba B. I", me procedurë të negocimit të ofertës,
7. Kërkesë nr.17660 nga Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Kamenicë,
8. Propozimi për nismën për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Ranillugut në fushën e Zjarrëfikësve, Mamegrafisë dhe Realizimin e Studimit të fizibilitetit për ujë të pijes për Ranillug dhe Fëtrrit,
9. Propozim-Vendim për plotësimin e vendimit bazë nr.7342,
10. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, para se me filluar konstatojnë se kemi kuorin më mjaftueshëm për të filluar seancën, a keni propozime për plotësim-ndryshim të rendit të ditës?

Nëse nuk keni unë kam kështu për propozime, propozimi i parë është:

1. Propozim-Vendim për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër

Kush është që të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abstenim.....0

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- janë tri propozime të njëjta dhe kisha kërkuar që të hynë në një pikë të vetme të rendit të ditës, kanë të bëjnë për Vlerësimin nga fatkeqësitë natyrore, njëra është për z. Benjamin Rudhani, Ardian Kurteshi dhe Shkolzen Mehmeti dhe të gjithë këta kanë pësuar nga fatkeqësitë natyrore i kanë edhe raportet.

Kush është që të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abstenim.....0

Magbule Kastrati- pasi isha në komision për " Bonevet" pse nuk është si pikë e rendit të ditës?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-është në pikën e 9-të të rendit të ditës, nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim miratimin e tërësishëm të rendit të ditës me ndryshime e bëra?

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abstenim.....0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 5-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime ose vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abstenim.....0

2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Egzona Isufi, kam një pyetje për kryetarin rreth 6-të punësimeve që janë bërë për avokat, kur dihet që ka avokat që paguhet këtu brenda për brenda, ndoshta do të ishte më mirë të jenë avokat të qytetit tonë pasi që edhe paguajnë taksa, ndoshta do të ishte edhe më mirë me pas inxhinier të kualifikuar ngase në lagjen " Liria" shtegu i biçikletave ka humbur krejt.

Sejdi Kurteshi-për ditën e çlirimit është organizuar një koncert, sa i ka kushtuar buxhetit të komunës, pasi e dimë se këta yje që ishin e kanë një kosto të lartë?

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës, Komuna e Kamenicës si çdo shpenzim tjetër që bënë përmes procedurave të prokurimit publik e ka zhvilluar edhe procedurën për shërbime juridike dhe kemi pasur dy oferta të cilën e kemi shpërblyer me kontratë dhe nuk

kemi pasur interesim nga avokatët e komunës tonë. Sa i përket inxhinierëve, nuk po e dij se si po e vlerësoni cilësinë e dobët të punëve me masën më të madhe jam i kënaqur me administratën e komunës së Kamenicës, inxhinierët po bëjnë punën më të mirë të mundshme dhe shtegu i biçikletave është më standardë 70 cm të shtegut të çiklizmit ekzistojnë aty.

Sa i përket pyetjes së z. Sejdi Kurteshit, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka organizuar edhe disa aktivitete të tjera ata i kanë përcaktuar edhe agjendat dhe për neve ka qenë nderë i jashtëzakonshëm që në skenë për ditën e çlirimit janë bashkangjitur figura dhe emra eminent të muzikës së mirëfillta shqiptare. Mendoj se një bagazh i tyre kaq i lartë i kanë bërë nder edhe Kamenicës dhe ditës së çlirimit dhe çfarë do kosto që ka qenë e arsyeton në këtë ditë unë e dij se kostot kanë qenë minimale por do i presim raportet të shpenzimit të buxhetit dhe i shohim në ato raporte.

Donjeta Ismajli-kur po pyesni për kostot do të ishte mirë që të merrnit pjesë të paktën në seancë dhe tek varrezat.

Sejdi Kurteshi-askush nuk e kontestojë që ata nuk janë të mirë, por unë pyeta për kosto sa ka kushtuar nata për ata yjet e estradës?

Jeton Biqkaj-çështje që shtrihen unë mendoj se nuk duhet të injorohen as nga Kryetari e as nga Kryesuesi e as nga grupi i VV-së, ngase u shtrua çështja e avokatëve, cilat pagesa, cilat shërbime i kryejnë dhe cili është interesi i komunës. Pse gjithë këto shërbime të avokatisë? A nuk është paraparë me kohë buxheti, qoftë për punëtorët shëndetësor, arsimor, kontratës kolektive etj.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës- serioziteti vjen si reflektim i pyetjes jo serioze dhe në mangësi të pyetjes që ngritet na japim përgjigje. Unë e thash se stafi merret me organizim unë i takoj palët që vijnë me marrëveshje ose vijnë na nderojnë sikur figurat e skenës muzikore shqiptare por për dakordimin e çmimit janë një drejtori e plotë dhe e dij se vlera ka qenë minimale. Unë po i pres të gjitha komentet edhe pse nuk janë konform rendit ditës, këtu është pyetje dhe ju më shumë bëni komente. Raportet financiare e dëshmojnë mbi nivelin e shpenzimeve që e bëjnë në çdo proces administrativ për mua nuk është e pranueshme me bërë pyetje që nuk keni marrë pjesë në ditën më të rëndësishme të komunës, as në seancë solemne si asamblistë, as në homazhe të dëshmorët e kombit, kurse po pyetni për kostot e koncertit.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me këtë situatë nuk mund të vazhdojmë seancën duhet të respektohet njëri-tjetri dhe të dëgjohet.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës- sa i përket punës së avokatëve që e ngriti z. Biqkaj, është vetëm një person që merret me instancat gjyqësore për kontestet që merret komuna e jonë. 756 mësimdhënës i kemi, asnjëri prej tyre nuk kalon pa shkruar padi për kontratat kolektive dhe për të gjitha ato padi duhet me shënuar përgjigjen në padi. Ku janë rastet e tjera pronësore, konfliktet me operatorët ekonomik etj dhe është e pamundur një person të mbrojë e të ngris në shkallën e dytë e të tretë pa një ekip ndihmës. Kjo ka qenë më se e domosdoshme me marrë shërbime mbështetëse për landë që ndoshta janë edhe më komplekse dhe jo vetëm për përfaqësim të mbrojtjes së komunës por në gjitha rastet tjera që ka një konflikt komuna e Kamenicës. Puna e seriozitetit të kuvendit ekziston gjithmonë, në prezencën time dhe detyrën time që e bëjë në çdo seancë më jepet mundësia të jem këtu dhe gjithmonë do të jem, pyetjet që unë i di të jap përgjigje tek ju dhe ato që nuk i di mund të shkoni edhe përmes rrugës zyrtare për përgjigje të kërkuara, ne jemi prej 5 komunave më transparente në Kosovë të publikuara në Eëb. Vlerat kanë qenë minimale dhe ju lus që të prisni raportet financiare.

Lirim Kryeziu-për ujësjellësin kemi nënshkruar një marrëveshje me të " Hidromoravës" dhe qytetarët e asaj pjese janë të interesuar të dinë se kur do të fillojnë kyçe, ngase u bë kohë e gjatë puna e ujësjellësit?

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës-puna e ujësjellësit në Roganë dhe posë fshatrat është udhëhequr si procedurë nga "Hidromorava" financuar nga Komuna e Kamenicës dhe Ministria e Ekonomisë, procedurë tenderuese ka përfunduar. Kycjet individuale kanë përfunduar në fshatin Dajçovc, do të vazhdojnë kycjet edhe në fshatin Roganë, kompania e ka pranuar avansin në vlerë prej 40 mijë euro dhe ka bërë porositë për materiale të nevojshme për me vazhduar punën në fshatin Roganë dhe besoj se po sa të vijnë materialet nga një shtet evropian siç është deklaruar edhe vet operatori ekonomik presim që të fillojë punën.

Magbule Kastrati-nuk ka nevojë kryetari me thënë delegatëve që nuk keni marrë pjesë në seancë për ditën e çlirimit.

Jeton Biqkaj-se si i vlerësojmë në dëshmorët është çështje e jona, asnjëherë as grupi i LVV-së nuk iu ka bashkëngjitur në të kaluarën seancave në këtë ditë të rëndësishme. Pasi pyetja ka të bëjë me çështje financiare është mirë të jepet përgjigje, ngase kuvendi e miraton buxhetin, nëse nuk e ke informatën në rregull jemi.

Sejdi Kurteshi- unë e di që mirë se ju kurrë nuk keni marrë pjesë në seanca solemne!

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, si kuvend bashkërisht me të gjithë anëtarët e kuvendit si kryesues kam ftuar seancën kemi bërë nderimet dhe jo vetëm ditën e çlirimit të Kamenicës por edhe në secilën festë që është për të gjithë popullin e Kosovës.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), për Komunën e Kamenicës për vitin 2025-2027,

Ardita Dërmaku- Drejtore për Buxhet dhe Financa, fillimisht kemi pranuar qarkoren e parë buxhetore me 15 maj nga Ministria e Financave, ku aty janë përcaktuar kufijtë fillestar ku pastaj zyrtari kryesor financiar u ka dërguar një qarkore të brendshme ku pas një afati të caktuar ku prape e kanë kthyer tek ne ku bashkërisht kemi përgatitur draftin e KAB-it. Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument strategjik ku në parim duhet të votohet çdo vit nga asambleja komunale, paraqet një analizë të hollësishme të shpenzimeve buxhetore komunale si dhe paraqet totalitetin e të hyrave të buxheteve komunale. Raportin që e keni pranuar i keni parë të gjitha objektivat e të gjitha drejtorive. Ne në pika të shkurtra do të paraqesim vetëm tabelën e buxhetit për vitin 2025: Për vitin 2025 komplet buxheti do të jetë 15,282,624.00 nga 14 milion 523,817.00 sa ishte për vitin 2024. Këto ndahen në grandin e përgjithshëm, grandin e arsimit, grandin e shëndetësisë, Shërbimet sociale rezidenciale si dhe të hyrat vetanake. Grandi i përgjithshëm për vitin 2025 arrin shumën prej 6,452,896.00, sa ishte në vitin 2024 5,976,303.00. Grandi i arsimit në vitin 2025 ishte 5,433,969.00. Grandi i shëndetësisë në vitin 2025 është 2,041,685.00 nga 1,892,973.00 që ishte në vitin 2024, si dhe shërbimet sociale rezidenciale në vitin 2025 janë 220,000.00 kurse në vitin 2024 është 197,272.00 dhe total grandet arrin shumën në 14,148,552.00, si dhe të hyrat vetanake për vitin 2024 janë 1,016,621.00, kurse në vitin 2025 janë 1,134,072.00 dhe total buxheti për vitin 2025 do të jetë 15,282,624.00. kemi një rritje prej 5.22 krahasuar me vitin 2024. Total buxheti shpërndahet në kategori të shpenzimeve, paga dhe mëditi, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale. Për vitin 2025 për paga janë planifikuar 9,090,500.00 euro, mallra dhe shërbime janë 2,422,098 euro, shpenzime komunale janë 262,000.00, subvencione 855,000.00, dhe investime kapitale 2,623,026.00. Nga ana ime ishte kaq nëse keni pyetje urdhënoi?

Florim Kryeziu-sa drejtori i ka komuna, po, që në dhjetor kemi ndërruar statutin e Komunës për me u bërë një drejtori të re për investime kapitale dhe në kornizë janë paraparë dyjat.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës- Komuna e Kamenicës i ka 11 drejtori po aq sa i ka pasën edhe në të kaluarën e kemi fuqizuar një drejtori atë të shërbimeve Publike me drejtorinë e Emergjencave dhe është krijuar drejtoria për Investime Kapitale. Neve na duhet me parapa drejtorin për Investime Kapitale në KAB, në mënyrë që me krijuar kodin ekonomik drejtorisë përkatëse. Është e domosdoshme parashikimi i drejtorisë së re që është brenda statutit të saj në mënyrë që ti drejtohet buxheti dhe projektet të i udhëheq ajo gjatë prezantimit ka pas mundësi që drejtoresha të bëjë gabime, kurse në dokument unë e dije se janë shifra të sakta ngase ky dokument pastaj i nënshtrohet ligjshmërisë. Sa i përket lokaleve nëse ata janë ankuar në polici ne nuk i kemi kompetencat me ndërhyrë tek policia ka ligje që i zbaton vetëm policia ne nuk po i shqetësojmë ne po i ndihmojmë bizneset i kemi ndarë 200 mijë euro qe dy vite për biznese. I shqetësojmë kur i thenë rregullat, jashtë rregullave komunale dhe jashtë ligjit që e ka votuar Kuvendi i Republikës së Kosovës jemi për me marr masa.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhni në votim,

Kush është për miratimin e pikës së tretë?

Për.....17

Kundër0

Abstenim.....0

4. Propozim-Vendim për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028,

Hysen Jerliu-Udhëheqës i mbeturinave, kemi mbajtur disa takime i kemi përfunduar të gjitha procedurat. Ky dokument është shumë me rëndësi dhe i ka munguar komunës tonë, ky dokument kërkohet në shumë fusha e sidomos tek transparenca e cila ka disa poena dhe mund të përfitojmë. Unë besoj që para vete e kemi materialin, ky ka qenë edhe në debat publik dhe është një material i gjatë, rëse keni pyetje, përcjftje ose sugjerime fjala është për ju?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhni në votim,

Kush është për miratimin e pikës së katërtë?

Për.....20

Kundër0

Abstenim.....0

5. Propozim-Vendim për miratim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për " Qëndresa Gagica Hajdari B.I" me procedurë të negocimit të ofertës,

Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, bëhet fjalë për negocimin e Qëndresa Gagica Hajdari, që ka shpreh interesimin me ardhjen me investuar në ndërtimin e një ferme. Pas zhvillimit të negociatave palët negociuese u pajtuan negociuese u pajtuan në pikat si më poshtë: Komuna e Kamenicës jep në shfrytëzim 204 mijë 187 m² sipërfaqen, afati i dhënies së pronës është 20 vite. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës është lehtësimi i

projektit ndërtimi i fermës së përzier, me kapacitet dhe aktivitete si në projektin e propozuar. Qëndresa Gagica Hajdari B.I në kompensim për shfrytëzimin e pronës komunale do të paguaj komunës qira vjetore 1160 euro, çmimi i qeras së tokës është i përcaktuar në rregulloren komunale. Vitin e parë që lirohet nga pagesa deri në implementimin e projektit. Vlera e investimit është 320 mijë euro për të siguruar investimin dhe realizimin e planit investues Qëndresa Gagica Hajdari detyrohet të ofrojë një polis të sigurimit apo garancion bankar në vlerë prej 20 mijë euro e cila do të shërbejë në rast të dështimit të investitorit. Qëndresa Gagica Hajdari, raporton tek komuna çdo 6 muaj mbi implementimin e projektit dhe vlerën e investimeve. Duhet të përfundoj investimet sipas planit të biznesit në afat prej një viti, numri minimal i punëtorëve +4 punëtorë nuk guxon të bie më poshtë nga asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me komunën prej momentit që fillon punën me kapacitet të plotë. Do të synohet maksimalisht që punëmarrësi të jetë banorë të komunës së Kamenicës, burimet natyrore nuk i takojnë shfrytëzuesit të tokës komunale përveç për të përdorur brei da kompleksit të ndërtuar. Banorët përreth që shfrytëzojnë burimet e ndryshme natyrore nuk guxojnë të pengojnë në shfrytëzimin e tyre pa miratimin paraprak të komunës. Sipas ligjit për sponsorizim biznesi do të përzgjedh një nga organizatat e sportit ose artit biznesi do të përzgjedh një nga organizatat kulturore sportive të Komunës së Kamenicës për sponsorizim. Ndryshimi i destinimit të shfrytëzimit të pronës komunale nuk mund të bëhet pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës. Unë besoj që është një projekt i mirë në zhvillim të komunës tonë.

Sejdi Kurteshi-ku gjendet kjo tokë?

Burbuqe Leka-Drejtor e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë-kjo pronë gjendet në Çarakoc e numri i parcelës është P-710 07079-01371-0.

Florim Kryeziu- me i dhënë 20 ha/tokë për një fermë mendoj se janë shumë dhe a keni formuar ndonjë komision për këto 20 ha/tokë dhe në cilën pjesë të Çarakocit i bie kjo tokë, a ka ndonjë rrugë, dhe a e din se sa tokat mbylleen nëse ju e jepni këtë pronë ? Pyetja tjetër se çka do të thotë ndërtim i fermës së përzier?

Burbuqe Leka-Drejtor e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë-është i formuar komisioni që është i autorizuar nga kryetari për negociimin e ofertave të tilla që vinë nga investitorët e ndryshëm. Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë. Kryesuese e komisionit është Qëndresa Kastrati, drejtori i urbanizmit Uran Berisha, nga drejtoria e pronës Ramush Ismajli, Petrit Vokshi dhe Durim Biqkaj.

Florim Kryeziu- kryetar a jeni për me i dhënë 20 ha /tokë ?

Hasan Krasniqi- mua nuk më duket çudi nëse i jepen 20 ha/tokë diku që pretendon me pas fermë, pasi është çështje e blegtorisë dhe normal që vyen hapësira të mëdha për mua këtë 20 ha/tokë janë të mjaftueshme.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës-unë nuk mund të them që nuk jam pajtuar për dhënien e kësaj prone pasi që e kam nënshkruar kushtet e negociimit për këtë pronë. Nëse biznesi plani i znj. Gagica ju duket i paarsyeshëm atëherë mos e miratoni. Unë besuar se znj. Gagica ka kapacitetin e saj m'u zgjeruar, stallën e përzier ashtu siç e ka paraqitën në plan të biznesit.

Florim Kryeziu-unë nuk jam për mos me përkrah deri në 5 ha/tokë, ama me ju dhënë 20 ha/tokë me këtë kontratë si delegatë nuk po bindem, ngase serioziteti i firmës i njerëzve nuk po më bind. Ngase, i keni lënë hapësirë që 5 vite t'i blejë këto dhentë, dhitë, lopët, serioziteti i një fermeri të mirë që në komunën tonë shumë pak kemi.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës- ju mundeni edhe të propozoni kushte të reja qoftë edhe me shkurtuar afatin për me përmbush projektin.

Florim Kryeziu- nuk jam për me ngrit qirajën, nëse është nevoja edhe për një vit ose dy me dhënë edhe pa qira vetëm ata që e kanë seriozisht me marrë tokë të komunës nuk i kanë vetëm 2 mijë euro në bankë, por duhet diku deri në 50 mijë euro, ngase nëse blihen 90 krerë

lopë aq do i kushtojnë. Pse nuk na u sjell lista e pronave, sa toka janë dhënë qe 20 vite, nga tokat që kemi dhënë sa firma janë të suksesshme, listën e subvencioneve?

Selim Maliqi- sa i përket znj. Gagica që u tha nga z. Kryeziu që nuk ka dhënë edhe dhi është e vërtetë që nuk ka. Znj. Qëndresa qe dy vite ka dalë si fermerë në Çarakoc, unë i shoh se komplet si familje janë të interesuar të merren me një fermë serioze. Unë mendoj se edhe 40ha/tokë janë pak nëse vërtet dëshiron me ngrit një fermë. Fermë e përzier është kur ke dele, dhi dhe lopë dhe unë mendoj se nuk janë shumë 20 ha/tokë për një fermë të tillë. Për momentin znj. Qëndresa i ka 24 krerë lopë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 5-të?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abstenim.....0

6. Propozim-Vendim për miratim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B. I", me procedurë të negocimit të ofertës,

Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë-bëhet fjalë për z. Veton Kallaba dhe qëllimi i dhënies së pronësi komunale në shfrytëzim për subjektin në fjalë është jetësimi i projektit "ndërtimi i fermës për pula vojse --bio me infrastrukturë përcjellëse me kapacitet dhe aktivitete si në Projektin e propozuar. Objekt të negocimit ka qenë zona kadastrale Çarakoc, në sipërfaqe prej 80780m², kurse komuna ja ka ndarë 50 mijë m², afati i dhënies me qira është 20 vite. Veton Kallaba B.I në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do të paguaj komunës qira vjetore në vlerë prej 1% të qarkullimit vjetor nga subjekti Veton Kallaba B.I, por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregulloret komunale. Vlera e investimit nga Veton Kallaba do të jetë 277,525.00 euro sipas planit dinamik zhvillimor financiar. Për të siguruar investimet dhe realizimin e planit investues Veton Kallaba B.I detyrohet të ofrojë policë të sigurimit apo garancion bankar në vlerë prej 10,000.00 euro e cila do të shërbejë në rast të dështimit të investitorit. Raporton tek Komuna e Kamenicës çdo 6 muaj mbi implementimin e projektit dhe vlerën e investimeve. Komuna e ka të drejtën në rast se nuk e përmbush kontratën me shkëput kontratën. Veton Kallaba duhet të përfundojë investimet sipas planit të biznesit në afat prej (1) viti nga pajisja me leje adekuatë. Numri minimal i punëtorëve, plus 4 punëtorë nuk guxon të bie më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik. Do të synohet që maksimalisht që punëmarrësit të jenë banorë të Komunës së Kamenicës. Burimet natyrore (si psh burimet eujt) nuk i takojnë shfrytëzuesit të tokës komunale përveç për përdorim brenda kompleksit të ndërtuar. Banorët përreth që shfrytëzojnë bujqësi të ndryshme natyrore nuk guxojnë të pengohen në shfrytëzimin e atyre resurseve pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës. Sipas ligjit për sponsorizim të (sportit dhe artit) biznesi do të përzgjedh një nga organizatat kulturore apo sportive të Komunës së Kamenicës për sponsorizim. Ndryshimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës komunale nuk mund të bëhet pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës. Jam e hapur nëse keni pyetje?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 6-të?

Për.....21

Kundër0

Abstenim.....0

7. Kërkesë nr.17660 nga Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Kamenicë,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi kërkesën nga Kryqi i Kuq edhe viteve të kaluara vjen e njëjta kërkesë me qëllim të financimit rreth shpenzimeve të rrymë, ujit, mbeturinave, derivateve të naftës, në vlerë prej 1990 euro a keni diskutime, nëse nuk keni e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së 7-të?

Për.....21

Kundër0

Abstenim.....0

8. Propozim për nismën për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Ranillugut në fushën e Zjarrfikësve, Mamografisë dhe Realizimin e Studimit të fizibilitetit për ujë të pijsh për Ranillug dhe Petrit,

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës-disa propozimet mes Komunës së Kamenicës dhe asaj të Ranillugut vetëm se kanë qenë duke u dhënë disa shërbime, shërbimet e zjarrfikësve, shërbimet mjekësore, administrative përmes stafit komunal. Ne jemi takuar me nënkryetarin për Komunitete z. Artan Dubovën dhe kryetarin e parë të kësaj komune ku jemi shprehë të gatshëm që këtë bashkëpunim ta kthejmë në mënyrë ligjore. Kuvendi Komunal i Ranillugut në seancën e kaluar e ka miratuar marrëveshjen për nismën dhe ka mbetur që edhe komuna jonë e ka filluar po të njëjtën gjë. Në këtë pikë është edhe studimi i fizibilitetit për ujë të pijshëm për Petrit dhe Ranillug. Në fshatin Petrit uji i pijshëm po del të jetë problematik dhe nëse ne arrijmë të gjejmë ujë të pijshëm në territor të komunës së Ranillugut do të bëjmë shpime dhe të furnizojmë komunën e e Ranillugut edhe fshatit Petrit me ujë të pijshëm.

Florim Kryeziu-pse për këtë pikë nuk është nënkryetaria për komunitete prezentë, pasi kur ishit në marrëveshje sigurisht edhe ajo ishte prezentë.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës- ky është propozim-vendim i kryetarit.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 8-të?

Për.....19

Kundër0

Abstenim.....0

9. Propozim-Vendim për plotësimin e vendimit bazë nr.7342,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ky propozim ka të bëjë me vendimin që është nxjerr për " Bonevet" më datë:7.3.2024, ne e kemi dërguar për shqyrtim në MAPL-por këta të fundit nuk na kanë kthyer përgjigje deri më 13.06.2024 dhe ne si komunë kemi marrë gjitha hapat ku kemi organizuar procedurën e ankandit komisioni e ka caktuar çmimin e vlerës fillestare dhe është zgjedhur fituese dhe tani jemi në fazën e hartimit të kontratës si vërejtje prej MAPL-së rreth vendimit bazë ka qenë përmirësimi i vendimit vetëm në një fazë ku prona të jepet pa kompensim dhe e njëjta me propozimin e ri zëvendësohet që

prona të jepet me kompensim me ligjin në fuqi. Ky përmirësim ka qenë nga MAPL si dhe pjesa e podrumit prej 66 m² e cila është pjesë përbërëse e lokalit me numër të njëjtë kadastral.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhni në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 9-të?

Për.....19

Kundër0

Abstenim.....0

10. Propozim-Vendim për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër

Latif Sylaj-Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare -e cila gjendet tek kisha ne kemi bërë një propozim-vendim pasi që kjo QMF nuk i plotëson kriteret për me funksionuar si QMF e as si AMF. Si shkak kryesor është mungesë e mjekut, ka pasur konkurse të vazhdueshme, prandaj ne i kemi sistemuar infermieret në QKMF, mirëpo ato nuk janë lajmëruar dhe vazhdojmë me procedurat dhe rregulloret që janë në fuqi. Tjetra është edhe infrastruktura që nuk i plotëson kriteret, ngase është një lokal i vjetër, një hapësirë e ngushtë dhe largësia nga QKMF është shumë e vogël dhe kjo është arsyeja e këtij propozim-vendimi. Edhe udhëzimi i ri administrativ 04/2020 e ndalon që infermieret me dhënë ndonjë terapi ose ineksione pa prezencën e mjekut.

Rabit Dërmaku-që sa kohë ata punëtorë që janë infermier nuk kanë ardhjen në punë dhe a kanë filluar masat disiplinore për ata punëtorë? Sa punëtorë janë momentalisht në kuadër të sistemit shëndetësor të Kosovës, pasi që aty punojnë dy sisteme ai paralel dhe ai i Kosovës dhe a ka ndërmarrë masa inspektoriati në mbylljen e kësaj QMF-je pasi nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për punë?

Latif Sylaj-Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-janë 7 infermiere prej tyre dy farmacistë dhe 5 infermiere të përgjithshme, masat i kemi filluar ato kanë të drejt ankese dhe tani për momentin juristen e kam në pushim dhe pas pushimit do të lëshohet vendimi për suspendim ngase nuk janë lajmëruar në punë.

Kadri Rahimaj-Kryetari i Komunës së Kamenicës-e para udhëzimi administrativ e përcakton qartë e shtëpive të shëndetit, nuk ka asnjë kuptim që brenda qytetit ku është QKMF-ja me pas edhe një QMF, këtu është shkelja e parë që nuk ka nevojë ndërhyrja e inspektoriatit në aspektet e sanitaris dhe mirëmbajtjes edhe nëse ish fuar inspektoriati do të dilte që është objekt i papërshtatshëm. Ne jemi duke e respektuar udhëzimin administrativ edhe për arsye që niveli i shërbimeve që merren aty është shumë i vogël dhe komiteti serb më shumë vinë në QKMF për shkak edhe të barnave edhe cilësisë edhe pastërtisë dhe gjithçka tjetër. Ne kemi parë që ka sistem paralel aty që me të vërtet duhet të mbyllet sepse nuk lejojmë që objektet tona të shfrytëzohen nga sistemet paralele.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhni në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 10-të?

Për.....17

Kundër0

Abstenim.....0

11. Propozim-vendim për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore për : Ardian Kurteshi, Shkëlzen Mehmeti dhe Benjamin Rrudhani

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi tre propozim vendime që i kemi bashkuar në një pikë është: e para është dëmi i shkaktuar nga shiu për fermën e Ardian Kurteshi vlera e dëmit është mjaft e madhe dhe komuna ka paraparë prej 4,731.00 euro, dëmet tjera është në pemishten e Shkëlzen Mehmeti që është vlera prej 8,799.00 euro si dhe Benjamin Rrudhani të cilit iu ka dëmtuar serra dhe dëmi i saj është konsideruar 624.50 euro.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së 11-të?

Për.....17

Kundër0

Abstenim.....0

12. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 11:25

Procesmbajtës

Sabile Arifi

Sabile Arifi

Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHËRBIM TE QY.
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 23271
U. Br.

Nr. i faq. 10 Data: 22/07
Datum: 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



ZAPISNIK

Sa VI-se sednice Skupštine Opštine

Sednica održana u opštinskom objektu, dana: 21.06.2024 i počela u 10:10 časova. Na sednici osim odbornika, prisutni bili i Predsednik Opštine, nekoliko direktora opštinskih odeljenja, stručna skupštinska Služba, prevodilac, kancelarija informisanja, predstavnik Kancelarije za Evropske Integracije, iz NVO-e, OEBS-a itd. Sednicu otvorio i njome predsedavao Predsedavajući Skupštine Opštine, Liridon Kastrati koji za sednicu predložio sledeći:

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa V-te sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,
2. Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti,
3. Razmatranje i usvajanje Srednjoročnog Budžetskog Okvira (SBO), za Opštinu Kamenica za period 2025-2027,
4. Predlog Odluke za usvajanje Plana lokalnog drumskog saobraćaja u Opštini Kamenica za period 2024-2028,
5. Predlog Odluke za usvajanje za davanje na duži rok Opštinske nepokretne imovine za " Qëndresa Gagica Hajdari IB" postupkom pregovaranja na ponudu,
6. Predlog Odluke za usvajanje za davanje na duži rok Opštinske nepokretne imovine za " Veton Kallaba IB", postupkom pregovaranja na ponudu,
7. Zahtev Crvenog Krsta Kosova Ogranak u Kamenici br.17660,
8. Predlog Odluke za pokretanje međupštinske saradnje sa Opštinom Ranilug u oblasti Vatrogastva, Mamografije i Realizacija Studije fizibiliteta/izvodljivosti za pijaću vodu za Ranilug i Petrovce.
9. Predlog Odluke za dopunu osnovne odluke br.7342, i
10. Razno.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, pre nego što počnemo konstatuje da imamo dovoljan kvorum za početak sednice, imate li predloga za izmene ili dopune dnevnog reda?

Ako nemate vi ja imam četiri predloga, prvi je:

1. Predlog Odluke za Zatvaranje Centra Porodične Medicine (CPM-e) Centar - Kamenica

Ko je da se ova tačka stavi u dnevni red?

Za su svi

Protiv.....0

Uzdržano.....0

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – imamo tri ista predloga i tražio bih da objedinimo u jednu tačku dnevnog reda, odnosi se na Procenu od prirodnih Katastrofa, jedna je za g. Benjamin Rudhani, druga za Ardian Kurteshi i treća za Shkelzen Mehmeti, svi su ovi stradali od prirodnih katastrofa, imaju i izveštaje.

Ko je da se stavi u dnevni red?

Za su svi

Protiv.....0

Uzdržano.....0

Magbule Kastrati- pošto sam bila član komisije za „Bonevet – Uradi sam“ zašto nema kao tačka dnevnog reda?

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –ima u 9 tački dnevnog reda, ako nema drugih diskusija, stavljam na glasanje pun dnevni red sa izvršenim izmenama?

Ko je za usvajanje dnevnog reda?

Za su svi

Protiv.....0

Uzdržano.....0

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa V-te sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, ima li diskusije ili primedbe na zapisnik, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje zapisnika?

Za su svi

Protiv.....0

Uzdržano.....0

2. Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti

Egzona Isufi, imam pitanje za predsednika za 6 zaposlenih advokata, kada se zna da ima advokati koji se ovde unutra se plaćaju. Možda bi poželjno bilo da su advokati iz našeg grada jer i oni plaćaju taksu. Možda bi još bolje bilo da imamo inženjera kvalifikovnog jer u naselje „Ilirija“ staza za bicikliste potpuno nestala.

Sejdi Kurteshi-za dan oslobođenja je organizovan koncert, koliko će koštati budžetu opštine, kada se zna da ove zvezde koje su bile skupo koštaju?

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica, Opština Kamenica kao svaki drugi rashod koji su ostvarili kroz postupke javnih nabavki za pravne usluge. Imali smo dve ponude koji smo nagradili ugovorom i nismo imali zainteresovanost od advokata naše opštine. Što se inženjera tiče, nije mi poznato kako procenjujete slab kvalitet radova u velikoj meri zadovoljan sam sa upravljanjem opštine Kamenica, inženjeri svoj posao obavljaju na najbolje mogući način i biciklistička staza je standardima od 70 cm, tu postoji kod biciklističke staze.

Što se pitanja g. Sejdi Kurteshi, tiče, odeljenja za Kulturu, Omladinu i Sporta organizovalo nekoliko aktivnosti, odredili i agende te po čemu je to bilo posebna čast da na sceni za dan oslobođenja kada su se pridružile istaknute figure i ličnosti prave albanske muzike. Mislim da su Kamenici i za Dan oslobođenja učinili veliku čast i bilo kakvi troškovi da su napravljeni za ovaj dan opravdava se. Znam da su troškovi bili minimalni, ali čekamo izveštaj troškova budžeta i videćemo te izveštaje.

Donjeta Ismajli-kada pitate za troškove bilo bi poželjno da najmanje učestvujete na sednicu i kod groblja.

Sejdi Kurteshi-niko nije osporavao da su mi dobri, ali pitao sam za troškove, koliko koštala noć za te estradne zvezde?

Jeton Biqkaj-pitanja postavljena ne treba ignorisati ni od strane Predsednika, ni od strane Predsedavajućeg ali i grupe SOP, postavljeno pitanje advokata, koje isplate, koje usluge vrše i koji je opštinski interes. Zašto toliko usluga advokature? Nije li na vreme predviđen budžet, bilo za zdravstvene, obrazovne radnike ili sa kolektivnim ugovorom itd.

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica – ozbiljnost dolazi kao refleksija neozbiljnog pitanja i u nedostatku pitanja koja se poteže mi dajemo odgovor. Rekao sam da se osoblje bavi organizovanjem, ja kontaktiram stranke koje dolaze za dogovor ili dolaze i nas poštuju kao figure albanske muzičke scene, dok za usaglašavanje cene postoji jedno kompletno odeljenje i znam da je cena bila minimalna. Mi očekujemo sve komentare mada nisu u sklopu dnevnog reda, tu je pitanje i previše pravite komentare. Finansijski izveštaji dokazuju za nivo troškova koji prave u svakom administrativnom procesu, po meni nije prihvatljivo da postavim pitanje kada niste bili prisutni na najvažniji dan opštine, ni na svečanoj sednici kao odbornici, ni na odavanju pošte kod palih boraca, a pitate za troškove koncerta.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, ovakvom situacijom ne možemo nastaviti sednicom, treba poštovati jedan drugog i da se sasluša.

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica – što se tiče rada advokata, pitanje koje potegao g. Biqkaj, samo je jedna ličnost se bavi sudskim instancama za sporove kojima se naša opština bavi. Imamo 756 nastavnika, nijedan ne prolazi a da ne podnosi tužbu za kolektivni ugovor i za sve ove tužbe treba napisati odgovor na pritužbu. Gde su drugi imovinski slučajevi, sukobi sa ekonomskim operaterima itd, i nemoguće je jedna ličnost da štiti i podnese drugom ili trećem stepenu bez jednog tima za pomoć. Bilo je neophodno dobiti usluge podrške za predmete koji su možda složeni i ne samo za zastupanje odbrane opštine nego u svim drugim slučajevima koji ima sukob opština Kamenica. Ozbiljnost rada skupštine uvek postoji, u moje prisustvo i moju dužnost koju obavljam na svakoj sednici pruža mi se prilika da budem ovde i uvek ću biti. Pitanja za koje ja znam vama dajem odgovor i za one koje ne znam možete i službenim putem zatražiti odgovor. Mi smo među 5 najtransparentnijih opština na Kosovu objavljeno na službenom sajtu. Vrednosti su bile minimalne te bi vas zamolio da sačekate finansijske izveštaje.

Lirim Kryeziu-za vodovod smo potpisali sporazum sa „Hidromorava“, i građani tog predela su zainteresovani da znaju kada će početi priključenje, jer radovi na vodosnabdevanje dugo trajali?

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica –vodovod u Rogačici i pet sela upravljala „Hidromorava“, finansirala Opština Kamenica i Ministarstvo za Ekonomiju, tenderski postupak završen, pojedinačni priključci u selo Dajkovce su završeni, nastaviće se i u selo Rogačica. Preduzeće prihvatilo avans/predajam u iznosu 40 hiljada evra i naručilo materijal za nastavak radova u selo Rogačica te sam uveren da čim materijal stigne iz jedne evropske zemlje kako je izjavio sam ekonomski operater, očekujemo radom da nastavi.

Magbule Kastrati-nije potrebno predsednik da kaže nismo učestvovali na sednici na dan oslobođenja.

Jeton Birqaj-kako mi cenimo pale borbe je naša stvar, nikada ni grupa SOP nije se pridružila sednicama za ovaj značajan dan. Pošto pitanje se odnosi finansija, poželjno je da se odgovor da, jer skupština usvaja budžet, ako nemaš informaciju u redu smo.

Sejdi Kurteshi- meni je dobro poznato, vi nikada niste učestvovali na svečanim sednicama!

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, kao skupština, zajedno sa svim skupštinskim odborima kao predsedavajući sazvao sam sednicu, odali smo poštu i ne samo na dan oslobođenja Kamenice nego za svaki praznik koji je za celi narod Kosova.

3. Razmatranje i usvajanje Srednjoročnog Budžetskog Okvira (SBO), za Opštinu Kamenica za period 2025-2027,

Ardita Dërmaku- Direktorica za Finansije i Budžet, na početku, 15 maja smo od Ministarstva Finansija primili prvu budžetsku okružnicu, tu su definisane početne margine, nakon toga glavni finansijski službenik dostavio internu okružnicu i nakon određenog roka ponovo su nama vratili i zajedno pripremali nacrt SBO-e. Srednjoročni Budžetski Okvir je strateški dokument i u načelu svake godine treba u skupštini opštine glasati, predstavlja podrobnju analizu budžetskih opštinskih troškova kao i predstavlja ukupne prihode opštinskog budžeta. Izveštaj koji ste primili imate sve ciljeve svih odeljenja. Mi u kratkim crtama ćemo prikazati samo tabelu za 2025 godinu. Za 2025 godinu kompletan budžet biće 15,282,624.00 od 14 milion 523,817.00 koliko je bilo 2024 godine. Taj iznos se deli na opšti grant, grant obrazovanja, grant zdravstva, stambeno socijalne usluge kao i sopstveni prihodi. Opšti grant za 2025 godinu iznosi 6,452,896.00, koliko je bio 2024 5,976,303.00. Grant obrazovanja 2025 godine bio 5,433,969.00. Grant zdravstva 2025 godine je 2,041,687.00 od 1,892,973.00 koliko je bio 2024, kao i stambeno socijalne usluge 2025 godine su 220,000.00 dok 2024 godine je 197,272.00 i grantovi ukupno iznose 14,148,552.00, kao i sopstveni prihodi 2024 godine su 1,016,621.00, dok 2025 godine su 1,134,072.00 što ukupan budžet za 2025 godine biće 15,282,624.00. imamo povećanje od 5.22 u poređenju sa 2024 godinom. Ukupan budžet se deli u kategoriju troškova, plate i dnevnice, robe i usluge, komunalni troškovi, subvencije i kapitalne investicije. Za 2025 godinu za plate planira se 9,090,500.00 evra, robe i usluge ima 2,422,098 evra, komunalni troškovi 262,000.00, subvencije 885,000.00, i kapitalne investicije 2,623,026.00. Od mene toliko, ako imate pitanja izvolite?

Florim Kryeziu-koliko odeljenja ima opština pošto decembra smo menjali statut Opštine, da bi se osnivalo novo odeljenje za kapitalne investicije i u okviru obe su predviđene.

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica – Opština Kamenica ima 11 odeljenja toliko koliko imala i u prošlosti objedinili smo u jedno odeljenje Javnih Usluga sa odeljenjem Vanrednih Prilika i formirano je Odeljenje za Kapitalne Investicije. Mi u SBO treba predvideti Odeljenje Kapitalnih Investicija, da bismo stvorili ekonomski kod dotičnog odeljenja. Neophodno je predvideti novo odeljenje što je u okviru statuta kako bi se i budžet usmerio i projektima upravljali. Tokom izlaganja moguće je bilo da je direktorica napravila greške, dok u dokumentu znam da su tačne šifre jer ovaj dokument posle podleže zakonitosti. Što se poslovnih delatnosti tiče, ako su se oni u policiju žalili, mi nismo nadležni da intervenišemo kod policije. Postoje zakoni koji sprovodi samo policija, mi ne uznemiravamo mi samo pomažemo poslovnim subjektima, već dve godine smo izdvojili 200 hiljada evra za njih. Uznemiravamo kada krši pravila, van opštinskih propisa i van zakona koji glasila Skupština Republike Kosova, jesmo da preduzmemo mere.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, ima li još diskusije povodom ove tačke dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje,
Ko je za usvajanje treće tačke dnevnog reda?

Za su svi.....17
Protiv0
Uzdržano.....0

4. Predlog Odluke za usvajanje Plana lokalnog drumskog saobraćaja u Opštini Kamenica za period 2024-2028,

Hysen Jerliu-Rukovodilac za otpad, održali smo nekoliko sastanaka završili smo sve postupke. Ovaj dokument je vrlo važan, našoj opštini nedostajao. Ovaj dokument se traži u mnogim oblastima, posebno kod transparentnosti koja uključuje nekoliko bodova i možemo dobiti. Verujem da imate materijal pred sobom, bio i na javnoj raspravi, materijal je obiman, ukoliko imate pitanja, primedbe ili sugestije, reć je na vama?

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, imate li diskusije po ovoj tački dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje četvrti tačke?

Za su svi.....20
Protiv0
Uzdržano.....0

5. Predlog Odluke za usvajanje za davanje na duži rok Opštinske nepokretne imovine za " Qëndresa Gagica Hajdari B.I" postupkom pregovaranja na ponudu,

Burbuqe Leka-Direktorka za Ekonomski Razvoj i Dijasporu, reć je o pregovoru Qëndresa Gagica Hajdari, koja izrazila interesovanje dolaskom da ulaže na izgradnji jedne farme. Nakon vođenja pregovora, pregovaračke strane saglasile se u sledećim tačkama: Opština Kamenica ustupa na korišćenje 204 hiljada i 187 m² površine, rok davanja imovine traje 20 godina. Svrha davanja na korišćenje imovine je olakšanje projekta izgradnja mešovite farme, sa kapacitetom i aktivnostima kao u predloženom projektu. Qëndresa Gagica Hajdari IB u naknadi za korišćenje opštinske imovine, opštini plaća godišnju kiriju 1160 evra. Cena zakupa zemljišta je utvrđena opštinskim pravilnikom, prvu godinu kada se oslobađa isplate do implementacije projekta. Cena investicije je 320 hiljada evra da bi obezbedila investiciju i realizaciju investicionog plana Qëndresa Gagica Hajdari dužna je da dostavi polis osiguranja ili bankarsku garanciju u iznosu od 20 hiljada evra koja će poslužiti u slučaju neuspeha investitora. Qëndresa Gagica Hajdari, izveštava opštinu svakih 6 meseci o sprovođenju projekta i iznosu investicija. Investicije treba da se završe prema biznijskom planu u roku od jedne godine. Minimalan broj radnika je +4 radnika, ne sme biti manje u nijednom periodu kalendarske godine bez koordinacije i usaglašeno biti sa opštinom od trenutka kada počinje radom punim kapacitetom. Teži se maksimalno da posloprimaoc bude stanovnik opštine Kamenica. Ljudski resursi ne pripadaju korisniku opštinskog zemljišta osim da se koriste unutar izgrađenog kompleksa. Stanovnici okolo koji koriste razne prirodne resurse ne smeju biti ometani u njihovoj koristi bez prethodnog usvajanja opštine. Prema zakonu sponzorstva biznisa izabraće jednu od sportskih ili umetničkih biznijskih organizacija Opštine Kamenica za sponzorstvo. Promena namene korišćenja opštinske imovine ne može se izvršiti bez prethodnog usvajanja od strane Opštine Kamenica. Ja verujem da je jedan dobar projekat u razvoju naše opštine.

Sejdi Kurteshi-gde je ova zemlja?

Burbuqe Leka-Direktorka za Ekonomski Razvoj i Dijasporu –ova imovina se nalazi u Čarakovce broj parcele je P-710 07079-01371-0.

Florim Kryeziu- za jednu farmu da se daju 20 ha/zemljišta mislim da su mnogo, i da li ste formirali neku komisiju za ovih 20 ha/zemljišta. U kom delu Čarakovca mu dođe ovo zemljište, ima li neki put i da li znate koliko parcela se zatvaraju kada ustupate ovu imovinu? Drugo pitanje je šta znači izgradnja jedne mešovite farme?

Burbuqe Leka-Direktorka za Ekonomski Razvoj i Dijasporu –formirana je komisija koju ovlastio predsednik za pregovor sličnih ponuda koje dolaze od raznih investitora. Komisiju čine 5 članova. Predsedavajuća komisije je Qëndresa Kastrati, direktor urbanizma Uran Berisha, iz odeljenja imovine Ramush Ismajli, Petrit Vokshi i Durim Biqkaj.

Florim Kryeziu- predsedniče da li ste saglasni da dajete 20 ha /zemljišta?

Hasan Krasniqi- mene ne čudi ako se joj daju 20 ha/zemlje, nekome ko želi da ima farmu, pošto se radi stočarstva, normalno treba imati velike površine. Po meni 20 ha/zemljišta je dovoljno.

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica –ne mogu da kažem da nisam se složio davanjem ove imovine, jer sam potpisao uslove pregovora za ovu imovinu. Ako plan biznisa g-de Gagica vam se čini neopravdanim nemojte usvojiti. Verujem da g-da Gagica ima kapacitet da proširi njen biznis, mešovitu štalu onako kako je prikazano u plan biznisa.

Florim Kryeziu-nisam da ne podržavam do 5 ha/zemlje ali da se daju 20 ha/zemlje ovim ugovorom, kao odbornik ne mogu da budem ubeđen, jer ozbiljnost firme ljudi ne me ubeđuje, jer stavili ste prostora da 5 godina kupuje ovce, koze i krave., ozbiljnost jednog dobrog poljoprivrednika što u našoj opštini njih malo ima.

Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica – vi možete predložiti nove uslove bilo i da se skрати rok za ispunjavanje projekta.

Florim Kryeziu- nisam zato da se kirija povećava, ako je potrebno i za jednu ili dve godine da se daje na zajam samo oni koji su ozbiljni da prihvate opštinsko zemljište, nemaju ni 2 hiljada evra u banci, ali treba negde do 50 hiljada evra, jer ako se kupuju 90 grla krava koliko će koštati. Zašto nije dostavljen spisak imovina, koliko za 20 godina je ustupljeno zemljišta, od zemljišta koju sino ustupili koliko firmi su uspešne, spisak subvencija?

Selim Maliqi- što se g-de Gagica tiče što kaže g. Kryeziu da nema ovce i koze, istina je da g-da Qëndresa nema. Dve godine ima kako je izašla u Čarakovce kao poljoprivrednik. Ja ih vidim kompletno kao porodicu koji su interesovani da se bave jednom farmom ozbiljnom. Ja mislim i 40ha/zemlje su malo ako zaista želi da podigne farmu. Mešovita farma je kada imaš ovce, koze i krave, mislim nije mnogo 20ha/zemlje za jednu takvu farmu. Trenutno g-da Qëndresa ima 24 grla krava.

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, ima li diskusije za ovu tačku dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje 5 tačke dnevnog reda?

Za su svi.....21

Protiv0

Uzdržano.....0

6. Predlog Odluke za usvajanje za davanje na duži rok Opštinske nepokretne imovine za "Veton Kallaba B.I", postupkom pregovaranja na ponudu,

Burbuqe Leka-Direktorka za Ekonomski Razvoj i Dijasporu u pitanju je g. Veton Kallaba te cilj davanja opštinske imovine na korišćenje za subjekat o kome je reč je sprovođenje projekta "izgradnja farme za piliće – organska sa pratećom infrastrukturom,

kapaciteta i aktivnostima kao u predloženom Projektu. Svrha pregovora bila katastarsko područje u Čarakovce površine od 80780m², ali je opština dodelila 50 hiljada m², rok davanja na zajam je 20 godina.

- Jam i caktuar Vendim të Kryetarit,zyrtar pergjegjës për kursimin e Energjisë.

- Kam bashkpunuar dhe kemi ndimuar ne programin **epasuria** me sektor të tjerave drejtorive,për kërkesat dhe problemet e tyre,dhe kam kryer punë
- Jam i Caktuar me Vendim te Kryetarit 3 Komisione anëtar i komisionit.

ZYRTARI I LOGJISTIKËS

Nr.	Vetura	Targat	Motori	Km.nisje	Km.mbarim	Gjithsej	Litra	L/100km
1	Kombi	112-131-06	Dizell	463931	0	0	0	0
2	Kombi	06Z-05-10	Dizell	408798	0	0	0	0
3	Hynday i20	06Z-03-10	benzin	220850	224486	3339	238	7.12
4	Shkoda	06Z-01-10	Dizell	302126	311845	9719	552	5.67
5	Shkoda	06Z-18-10	Dizell	237180	247806	10626	621	5.84
6	Shkoda	06Z-17-10	Dizell	228169	239249	9601	656	6.83
7	Toyota Prado	06Z-16-10	Dizell	284950	288595	3645	661	18.13
8	Shkoda	06Z-15-10	Dizell	120116	127216	7100	448	6.3
9	Hynday i30	06Z-19-10	Dizell	281479	284638	3159	211	6.67
10	Amarok	06Z-20-10	Dizell	85041	92168	7127	760	10.66
11	Amarok	06Z-21-10	Dizell	90358	97088	6730	665	9.88
12	Shkoll-kos	Shkollat	Di-Be	/	/	/	235	
13	Mitsubish	06Z-06-10	Dizell	171983	175129	3146	370	11.76
14	Mitsubishi	06Z-13-10	Dizell	258754	259971	1217	120	9.86
15	Cat-966	////////	Dizell	/	/	/	2730	/
16	Toyota Yaris	06Z-25-10	Dizell	8629	19542	10913	487	4.46

17	Toyota Yaris	06Z-26-10	Dizell	9560	20292	10732	584	5.44
18	Audi	06Z-29-10	Dizell		279864		505	
19	Toyota Yaris	06Z-30-10	benzin	0	10104	10104	287	2.84

NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT - NJKDNJ



- Bashkëpunim në mes Institutit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut - Antikorrupsion dhe Koordinatorës së NJKDNJ-së në Kamenicë
- Koordinatorja e NJKDNJ-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor ka siguruar të dhënat e kërkuar nga MMPH të cilat i ka përmbledhë me një raport dhe i ka përcjellë në MMPH

- Koordinatorja e NJKDNJ-së, ka mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe sektoret e komunës të cilat i ka përmbledhë në një raport mjaft voluminoz i cili do të përdoret për të monitoruar dhe vlerësuar progestin dhe sfidat lidhur me zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021-2025), të cilin ia ka dërguar Zyrës për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit.
- Me rastin e Ditës Botërore të Kancerit, Koordinatorja e NJKDNJ-së ka shpërnda materjale informuese sa i përket parandalimit të kësaj sëmundjeje..
- Mbajtja e takimeve të rregullta me anëtarët e grupit punues të MKKDHF dhe hartimi i Planit të Veprimit të Mekanizmit Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje në Kamenicë dhe ndjekja e procedurave ligjore diktimit publik, KPF dhe miratimi i tij në Kuvend më 30 maj 2024
- Koordinatorja e NJKDNJ-së ka pranuar vendim nga Kryetari i Komunës që është ngarkuar me detyrë shtesë sa i përket qështjes gjinore në raportin e performancës.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së ishte pjesë e konferencës së Javës së Gruas
- Dita Botërore e Sindromës DOVVN - Me rastin e kësaj dite Logopedja e IP ‘Filizat’ në bashkëpunim me Koordinatorë e NJKDNJ-së, kanë përgaditë një videomesazh në të cilën ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës dhe disa edukatore të cilat kanë dhënë mesazhe lidhur me këtë ditë.
- Mbajtja e takimeve të rregullta të Tryezës Ndihmëse për Menagjimin e Rasteve (TNMR)
- Dita Botërore e Autizmit - Me rastin e kësaj dite Koordinatorja e NJKDNJ-së është takuar me qytetar të grupmoshave të ndryshme me të cilët ka bashkëbiseduar rreth kësaj teme dhe ka shpërndarë fletpalosje me informacione rreth kësaj dite.

- Mbajtja e takimeve të rregullta me anëtarët e KLV dhe hartimi i Planit të Punës së Komitetit Komunal Veprues bazuar në Strategjinë e re për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe ndjekja e procedurave ligjore diktatori publik, KPF dhe miratimi i tij në Kuvend më 30 maj 2024
- Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Koordinatorin e NJKDNJ-së, cdo muaj organizojnë aktivitetin: “Ditë e hapur me qytetarë” ku qytetarët kanë mundësi të paraqesin ankesat e tyre tek Avokati i Popullit për shkeljen e të drejtave të njeriut.
- Divizioni për Drejtësi Tranzicionale pranë Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me NJKDNJ-në dhe me miratimin e DKA-së, organizuan ligjëratë me nxënësit e Gjimnazit “Ismail Qemali” në Kamenicë me temën: Drejtësia Tranzicionale / Ballafaqimi me të kaluarën. Trajner i kësaj ligjërate ishte z.Valdon Bytyci - Zyrtar për Drejtësi Tranzicionale pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Pjesëmarrje në takime të rregullta të Grupit të Grave të Kamenicës
- Dita Ndërkombëtare e Familjes - Në kuadër të kësaj dite, Koordinatorja e NJKDNJ-së ka përgaditur një videomesazh për rëndësinë e familjes dhe gjatë kësaj jave ka vizituar disa shkolla dhe iu ka shpërndarë nxënësve materiale sensibilizuese për rëndësinë e familjes ku thekson që mesazhi kryesor i kësaj fushate është: “Mbrotjtja fillon në familje”
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) me seli në Prishtinë në bashkëpunim me NJKDNJ kanë mbajtur sot takimin lidhur me identifikimin dhe fuqizimin e të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

- Koordinatorja e NJKDNJ-së së bashku me Drejtorin e Arsimit kanë organizuar Mbledhjen e radhës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Gjithashtu, gjatë kësaj dite secili nxënës ka përgaditur thënie për të drejtat e fëmijëve e që janë gjiruar dhe është përgaditur një video mesazh sensibilizues për të drejtat e fëmijëve, i cili është plasuar në veb faqen e komunës.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së, ishte pjesëmarrëse dhe në panel diskutimi në Konferencën Rajonale “Kontributi i OSBE-së në qeverisjen lokale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut - 25 vjet prezencë në Kosovë”
- Raportim për DNJ në Planin gjithpërfshirës të komunave për Integritet Evropian janar-qershor 2024
- Gjatë kësaj periudhe raportuese Koordinatorja e NJKDNJ-së ka marrë pjesë në shumë takim, punëtori e seminare organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit, MAPL-ja, Këshilli i Evropës dhe OJQ nga niveli lokal dhe qendror.

ZYRTARJA PËR INFORMATA

nr.	6 Mujori /Janar- Qershor 2024	Gjithesëjt
1	Totali i vizitave dhe kërkesave takim me Zyren e Kryetarit dhe Drejtoritë e ndryshme	415
2	Si dhe ka pas njoftime tjera për drejtori ,sektor dhe zyrtar individ që janë njoftuar palët por nuk janë marrë të dhënat.	////

ZYRTARJA ADMINISTRATIVE PËR PUNË TË KUVENDIT

- Gjate kësaj periudhe kam përcjellë mbledhjet e Kuvendit, mbledhjet e Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Politikë e Financa,
- Kam përgatitur procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjet e Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Politikë e Financa,
- Përgatis materialin e Komitetit për Komunitete dhe i njoftoj anëtarët e këtij komiteti për mbledhje,
- Kam ndihmuar në punët që më kërkohen nga kryesuesi ose asistentja e tij.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi:

Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi si organ i administratës komunale në Kamenicë, ka vepruar dhe vepron në zhvillimin e procedurave dhe detyrave konform kompetencave lëndore të parapara në statutin komunal, rregulloret dhe ligjet në fuqi, bazuar në evidencën-bazën tekstuale përmes fletëve poseduese, ku janë paraqitur të gjitha informacionet e pronarit dhe pronës, të cilat identifikohen përmes planeve gjeodezike, e tani në formën digjitale – ortofotot që posedon Drejtoria. Drejtoria Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi - Zyra kadastra le komunale (ZKK) e Kamenicës ka për qellim ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme, ngritja e cilësisë dhe saktësisë së shërbimeve .

Në mënyrë permanente jemi angazhuar dhe u kemi ofruar shërbime efikase të mundshme qytetarëve konform kërkesave të tyre dhe realizimin në afate sa

më të shpejta. Angazhimi i jonë është orientuar në një organizim të mirëfilltë në bazë të përparimeve dhe sistemeve të avancuara në nivele të kohës moderne, duke analizuar strategjinë bashkëkohore në bazë të sistemit të avancuar gjyqësor duke aplikuar Ligjin Kundër Diskriminimit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve, si nga tereni ashtu edhe në zyre. Një angazhim specifik është se po ballafaqohemi me lëndë nga vite shumë të kaluara, që ende nuk janë zgjidhur e që presin parashtruesit e kërkesave një zgjidhje meritore. Kemi lëndë në procedurë e sipër të viteve para 1999 e këndeje që duhet një angazhim – studim shumë i thellë dhe një procedurë e mundimshme për gjetjen e provave lidhur me kompletimin e lëndës për të gjetur zgjidhje meritore. Shumë lëndë janë të grumbulluara që nga viti 1991 e deri më 1999 nga ish pushteti i atëhershëm, ku dhe vërehen se kanë parregullsi procedurale e që presin zgjidhje, por të njëjtat paraqiten kohë pas kohe. Ne si Drejtori me një staf profesional jemi të përkushtuar për zgjidhje meritore konform bazave dhe afateve ligjore.

Stafi i Drejtorisë tonë është me një përvojë nga e kaluara dhe për çdo lëndë të komplikuar, tubohet, analizon dhe propozon zgjidhje meritore.

Drejtoria për PGJK përbëhet prej tre sektorëve:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Gjeodezisë
- Sektori i Pronësisë.(Jashtë Veprimit arsyeje pensionimi i zyrtareve të këtij sektori).

Është e njohur se kjo Drejtori si organ i administratës komunale , qytetarëve u shërben si një servis i përhershëm nga tri sektorët në Sektorin e Kadastërit, Gjeodezisë, Pronësisë dhe Zyra për Banime cila nuk funksionon po me kërkesë të OSGS duhet të formohet të jetë aktive ,arsyeja e ndryshimit të ligjit lidhur me regjistrimin e objekteve –banesave . Shërbime u ofrohen lidhur me qasjen e të Drejtave të Pronave për Pasuritë e Paluajtshme, Regjistrat e ndërrimeve të paluajtshmerive si për pronat private ashtu edhe për pronat publike komunale, procedurat e shpronësimit, rasteve për banim social.

Kemi pasur një bashkëpunim të shkallës së lartë edhe me të gjitha Drejtoritë tjera të administratës komunale, posaçërisht me;

Drejtorinë për D.U.P.H,

Drejtorinë për D.SH.P.A.I

Drejtorinë Për D.B.P.ZH.R,

Drejtorinë për D.E.ZH.D.

Nuk ka munguar bashkëpunimi edhe me Drejtoritë tjera sipas nevojës së interesit publik komunal.

Probleme serioze me theks të veçantë në DKGJP-si nuk ka,por është i nevojshëm një bashkëpunim më efikas duke pasur parasysh kohën-afatet ligjore për procedurat administrative dhe atë me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, me Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambientit dhe Inspektoratit dhe Drejtoritë tjera. Është evidente se në DKGJP ka punë të pa ndërprerë dhe numër të konsideruar të lëndëve e që për shqyrtim lypet edhe zënia e afateve ligjore, por duke pasur parasysh numrin e stafit të pakët, na paraqiten edhe vonesa të shqyrtimit të lëndëve. Sa i përket numrit të përgjithshëm të kërkesave që kanë arrit për këtë periudhë pran kësaj drejtorie, të regjistruara dhe të realizuara.

Këto kërkesa të realizuara kanë gjeneruar të hyra për komunën si më poshtë:

Ne si drejtori kem pas takime te rregullta me AKK lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimeve Administrative dhe ligjeve ne fuqi. Kem pas takime edhe me organizata te ndryshme dhe OJQ te cilat operoj ne republikën e Kosovës.

Vlen te përmendet se edhe këtë vit si drejtori jemi te privilegjuar nga AKK për 5 zona kadastrale për Rindërtim te shënimeve për palët pa pagës,.

50011 Trashëgimitë

Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Ndarje parcelash	20	16	10	03	03	02							54
02	Bashkim parcelash	05	04	08	00	02	02							21
03	Regjistrimi i ndërtesave	01	00	02	00	00	01							04
04	Ndarja e ndërtesave	00	00	00	00	00	00							0
05	Bashkimi i ndërtesave	00	00	00	00	00	00							0
06	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	01	02	01	00	01	00							05
07	Ndarja e pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00							00
08	Bashkimi i pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00							00
09	Regjistrimi i hipotekave	06	00	00	00	00	01							07
10	Çregjistrimi i hipotekave	02	00	00	00	00	00							02
11	Regjistrimi i shitblerjeve	43	16	23	21	15	16							134
12	Regjistrimi i trashëgimive	32	12	17	15	14	09							99
13	-/-/- i faljeve të pronës së paluajtshme	45	19	39	15	26	14							158
14	-/-/- i ndërrimit të pronës së paluajtshme	00	00	00	00	00	00							00
15	-/-/- i shkëputjes së bashkësisë familjare	00	00	00	00	00	00							00
16	-/- i përkujdesjes së përvetshme(Gjykat)	00	00	00	00	00	00							00
17	-/-/- i pronave të eksproprijuar	00	00	00	00	00	00							00
18	-/-/- i servitutit	00	00	00	00	00	00							00
19	Çregjistrimi i servitutit	00	00	00	00	00	00							00
20	Regjistrimi i tatimit në pronë	00	00	00	00	00	00							00
21	Çregjistrimi i tatimit në pronë	00	00	0	00	00	00							00
22	Te tjera	12	12	14	04	06	05							53
23	Regjistrim-Çregjistrimi i barrës tatimore	00	00	00	00	00	00							00
24	Regjistrimi i ngarkesave tjera	09	08	00	00	00	00							17
25	Çregjistrimi i ngarkesave tjera	00	00	00	00	00	00							00
26	Regjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	00	00	00	00	00	00							00
27	Çregjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	000	01	00	00	00	00							01
28	Regjistrimi i korrigjimeve në regjistër	02	00	00	00	00	00							02
29	Regjistrimi i rregullimit të kufiri	00	00	00	00	00	00							00
30	Regjistrimi i ndërrimit të shfrytëzimit akt	00	00	02	00	00	00							02
31	Regjistrimi i vërtetimit identiteti	11	01	01	09	08	07							37

Totali I k�rkesave	189	91	117	67	75	57							596
Te hyrat materiale euro	2440	1740	2830	1740	1658	870							11278 euro


50504 Matjet														
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Azhurnim	24	19	09	09	08	02							69
02	Matje	00	00	00	00	00	00							00
03	Parcelim	06	08	06	05	06	00							31
04	Bashkim parcelash	06	08	03	03	00	02							20
05	Kopje plani	00	79	79	76	49	18							283
06	Matje ndërtesash	00	00	00	00	00	00							00
07	Caktim kufijsh (Viktor Parcelave)	00	09	09	06	02	00							26
08	Koordinata	12	08	09	07	12	02							48
09	Identifikim	00	00	00	00	00	00							00
10	Ndarje	06	00	00	00	00	00							06
11	Rregullim kufijsh	00	00	00	00	01	00							01
12	Të tjera-Aplikacione	00	00	00	00	00	00							00
Totali i kërkesave		54	131	115	106	78	06							490
Te hyrat materiale euro		2237	2154	1654	1951	1395	587							9948 euro

50019 Certifikata														
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Certifikata pronësie, (fleta poseduese)	169	206	208	200	395	102							1178
02	Kopje plani	15	79	97	76	49	18							316
03	Vërtetime të ndryshme	07	04	03	06	00	03							20
Totali I kërkesave		191	289	308	282	444	123							1637
Te hyrat materiale euro		763	1063	1863	1060	2370	492							7611 euro

Pronësi														
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Shpronësim	////	////	////	////	////	////							////
02	Uzurpim	////	////	////	////	////	////							////
03	Aktvendime	////	////	////	////	////	////							////
04	Të ndryshme	////	////	////	////	////	////							////
05	Ekspedicion	////	////	////	////	////	////							////
06	Servitut	////	////	////	////	////	////							////
07	Procesverbale	////	////	////	////	////	////							////
08	Të Bartura	////	////	////	////	////	////							////
	Takime	////	////	////	////	//// /	////							////
	Total	////	////	////	////	////	////							////

Nr	Kodi		Kërkesa	Euro
01	50504	Matjet në teren Azhurnime te lëndëve	490	9948
02	50019	Certifikatat poseduese vërtetime dhe kopjet e planit	1637	7611
03	50011	Trashëgimit, shitblerjet, hipotekat	596	11278
Totali			2723 kerkes	28837 euro

Paraqitja Grafike



Vlen te përmendet se duke u krahasuar me vitin që lamë drejtoria për KGJP-si kemi ngrit të hyrat vetanake dukshëm më shumë se në vitin e kaluar çka kemi planifikuar në planin e veprimit për vitin 2024.

Për kryerjen e këtyre aktiviteteve me qëllim të arritjes së objektivave të parapara për Vitin 2024, kemi identifikuar disa sfida përkatësisht disa vështirësi të cilët mund të paraqiten si pengesë për arritjen e objektivave dhe rezultateve më të mira të parapara me plan.

Këta faktorë :

1. Numri i shërbyesve civil në DKGJP , sidomos mungesa e stafit të nevojshëm:

- a. Sektori i Pronësisë (2 juristë-te) pas pensionimit sektori është jo funksional me shume se 2vite .
- 2. Mungesa e dokumentacionit kadastral.(e marr nga ish sistemi)
- 3. Pengesat e shpeshta në sistemin e programit SIKTT /rënia e rrjetit të internetit.
- 4. Teknologjia shumë e vjetruar si: kompjuter printer dhe skaner.

Drejtoria Komunale e Arsimit:

#	Furnizimi	Operatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
1	Buk dhe brumra tjera	Premium Bakery	165,00 €	144,90 €		137,70 €	143,10 €		590,70 €
2	Furnizimi me artikuj te ndryshem ushqimor	Ananas Impex	272,86 €	193,00 €	245,16 €	328,80 €	397,40 €		1 437,22 €
3	Furnizim me mish gjedhi	Riki NTP	210,00 €	210,00 €	105,00 €	102,00 €	210,00 €	82,60 €	919,60 €
4	Furnizim me mish pule	Riki NTP	136,00 €	136,00 €	102,00 €	102,00 €	102,00 €		578,00 €
5	Furnizim me ushqim te shendetshem	Dauti Komerc	2 559,09 €	2 559,09 €	2 559,09 €	0,00 €	2 832,76 €	1 808,00 €	12 318,03 €
6	Furnizim me pem dhe perime	Dauti Komerc	588,96 €	560,16 €	304,64 €	285,60 €	314,00 €		2 053,36 €
7	Furnizim me produkte te qumeshtit	Dauti Komerc		174,60 €	174,60 €	71,35 €	277,80 €		698,35 €
8	Ushqim i ndryshem	Dauti Komerc	588,96 €	560,16 €	140,84 €		203,98 €		1 493,94 €
9	Mirembajtje	Demos SHPK			512,00 €		440,95 €		952,95 €
10	Furnizim me material higjenik	NTP Pashtriku			766,35 €		1 152,95 €		1 919,30 €
11	Furnizim i zyles	Mediatek					753,22 €		753,22 €
			4 520,87 €	4 537,91 €	4 909,68 €	1 027,45 €	6 828,16 €	1 890,60 €	23 714,67 €

Sherbime

#	Furnizimi	Operatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
1	Transporti		12 239,50 €	18 830,00 €	19 771,50 €	41 256,15 €	24 290,00 €	20 862,50 €	137 249,65 €
2	Mirembajtje e Platformes	Data prognet	1 350,00 €						1 350,00 €
3	Ekskursioni i maturanteve ne shqiperi						20 020,00 €		20 020,00 €
4	Mbramja e matures						4 990,00 €		4 990,00 €
5	Ekskursioni i semimaturanteve						1 755,00 €		1 755,00 €
			13 589,50 €	18 830,00 €	19 771,50 €	41 256,15 €	51 055,00 €	20 862,50 €	165 364,65 €

Investimet

Nr	Emri i Projektit	Vlera e Parashikuar	Menaxheri i Kontrates	Data e nenshkrimite kontrates	Pagesa	Vlera e kontraktuar
1	Mjete Didaktike	50 000,00 €	Xhemail Berisha	3.4.2024	0,00 €	41 515,70 €
2	Furnizim me material shpenzues për shkolla-Markera	9 000,00 €	Visar Krasniqi	4.4.2024	904,00 €	4 223,56 €

3	Furnizim me pajisje dhe materiale të ndryshme për kabinete në IAAP Andrea Durrsaku në Kamenicë	56 965,00 €		2.1.2024	0,00 €	55 000,00 €
4	Uniforma	21 840,00 €	Besnik Rrudhani	12.4.2024	21 840,00 €	21 840,00 €
5	Paisje Muzikore	10 550,00 €	Leotrim Llozani	//	0,00 €	10 740,00 €
6	Furnizim me perde dhe tepisona	27 000,00 €	Vlona Matoshi		0,00 €	24 480,00 €
7	Furnizim me inventar shkollor	42 420,00 €	Ramadan Guda		42 420,00 €	42 420,00 €
8	Terene Sportive		Mexhid Zylfiu		46 774,00 €	46 774,00 €
	Totali				111 034,00 €	246 993,26 €

Faturat e paguara - Komunalite

Faturat e Paguara							
Operatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
KESCO	2 998,88 €	3 381,76 €	3 071,58 €	1 630,33 €	1 920,01 €	1 516,25 €	14 518,81 €
Eco Higjena	321,50 €	1 100,50 €	1 069,50 €	930,00 €	1 209,00 €		4 630,50 €

Hidromorava	431,70 €	777,46 €	794,85 €	1 585,38 €	1 585,38 €	1 585,38 €	6 760,15 €
Telekomi	328,47 €	333,77 €	333,77 €	333,77 €	333,77 €		1 663,55 €
	4 080,55 €	5 593,49 €	5 269,70 €	4 479,48 €	5 048,16 €	3 101,63 €	
Gjithsej							27573,01
Vlera e planifikuar							52000
Te lira							24426,99

Subvencionet

Nr	Aktiviteti	Vlera
1	Vizita e maturanteve ne Itali	9 800,00 €
2	Nexhat Rexha - Botim i Librit	1 600,00 €
3	Shyhrete Demolli - Jusufi - Transport	300,00 €
4	Donjete Latifaj Mesimdhenese- Vizite ne Itali	300,00 €
5	Azem Tahiri - Trannsport	600,00 €
6	Baki Krasniqi - Botim i Librit	1 900,00 €
7	Haki Zuzaku - Trasnport	2 000,00 €

8	Endi Osmani - Shkollim	1 400,00 €
9	Sabri Morina - Botim i Librit	600,00 €

Raporti i përgjithshëm

	Te planifikuara	Realizimi	
Mallra dhe Sherbime	878 222,00 €	216 652,33 €	25%
Investime Kapitale	170 669,00 €	111 034,00 €	65%
Komunalite	52 000,00 €	27 573,01 €	53%
Subvencionet	100 000,00 €	18 500,00 €	19%
Totali	1 200 891,00 €	373 759,34 €	31%



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Nr. 02 Br. 23603
Nr. i faq. 3 Data: 24/7
Br. str. Datumi:
KAMENICE/A 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.286, dt 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, 24 dhe neni 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, neni 15,16 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 30 i ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, dispozitave të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05.L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe Kërkesës Sh.02.Nr.23537 i datës 24.07.2024 për Transfer dhe Rialokim e parashtruar nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h), Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të dates _____, nxjerrë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për transfer dhe rialokim të mjeteve

1. Miratohet vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategori për Subvencione dhe **shpenzimeve kapitale** për vitin 2024.
2. Mjetet për transfer dhe rialokim sipas pikës 1 të këtij vendimi janë si vijon:
3. Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor 10.

Nga:Programi Administrata dhe Personeli (163) nenprogrami Administrata (16329) ne shume prej 15,000.00.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Buxhet dhe Financa(175) nenprogrami Buxhetimi(17529) ne shume prej 2,950.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Zyra Komunale për Komunitete (195) nenprogrami Zyra Komunala per Komunitete dhe Kthim (19645) ne shume prej 740.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim rural (470) nenprogrami Bujqësia (47029) ne shume prej 4,400.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Kadastra dhe Xheodezia (650) nenprogrami Shërbimet Kadastrale (65145) ne shume prej 1,649.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale (755) nenprogrami Shërbimet Sociale (75641) ne shume prej 2,200.00€ fondi burimor 10

Nga:Programi Administrata dhe Shkenca (920) nenprogrami Administrata (92145) ne shume prej 20,000.00€ fondi burimor 10

Në Transferet/Rialokimet e mjeteve në kategori të Subvencioneve dhe Transfereve

Në Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 46,939.00€, fondi burimor 10

4. Nga Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor 21.

*Nga:*Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 7,490.00€ fondi burimor 21

*Nga:*Programi Administrata dhe Personeli (163) nenprogrami Administrata (16329) ne shume prej 6,735.00.00€ fondi burimor 21

*Nga:*Programi Buxhet dhe Financa(175) nenprogrami Buxhetimi(17529) ne shume prej 749.00€ fondi burimor 21

*Nga:*Programi Shërbimet Publike Mbrojtja ,Mbrojtja civile (180) nenprogrami Infrastruktura Publike (18189) ne shume prej 10,260.00€ fondi burimor 21

*Nga:*Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nenprogrami Planifikimi urban dhe Inspekcioni (66450) ne shume prej 2,998.00€ fondi burimor 21

*Nga:*Programi Administrata dhe Shkenca (920) nenprogrami Administrata (92145) ne shume prej 6,630.00€ fondi burimor 21

Në Transferet/Rialokimet e mjeteve në kategori të Subvencioneve dhe Transfereve

Në Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 34,862.00€, fondi burimor 21

5. Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 22 shuma prej 1,829.88€.

- **Nga Projektet:**

1. Projekti "Ndërtimi i trotuareve ne qytetin e Kamënices dhe fshatrat" Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66450) kodi i projektit 52839 në shumë prej 1,121.50€.
2. Projekti "Ndertimi i stadiumit ne Hogosht " Kulturë Rini dhe Sport (850) nënprogrami Shërbimet Kulturorë (85029) kodi i projektit 51134 në shumë prej 708.38€

- **Në projektin ekzistues "Renovimi i AMF-ve Busavatë,Topanicë,Karaqevë,Roganë dhe Hogosht " në programin Shendetesi dhe Mirëqenia Sociale (730) nënprogrami Administrata (73038) kodi i projektit ekzistues 55068 në shumë prej 1,829.88€**

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Kuvendit;
- Drejtorisë për Financa dhe Buxhet; dhe
- Arkivit.



76-DC

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
05	Doc. Prot. No. 5685
2	Date: 12.07.24
PRISHTINË / A	No. 2



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti Ligjor / Pravnim Departmanom / Legal Department

Për:	z.Kadri Rahimaj Kryetar i Komunës, Kamenicë z.Liridon Kastrati , Kryesues i Kuvendit Komunal, Kamenicë	
Kopje:	z. Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL z. Jeton Qela , Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL	
Përmes:	z. Hysen Durmishi, Zëvendësministër, MMPHI-së z. Izedin Bytyqi , Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm, MMPHI	
Nga:	Floriqe Boshnjaku , Drejtore e Departamentit Ligjor	
Zyrtarët përgjegjës:	Floriqe Boshnjaku,	 Datë: 12 Korrik 2024
1. zyrtari Konfirmues i Vlerësimit Ligjor		
2..Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit - Vendimit KK Kamenicë Nr.21038	
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.21038 për miratimin e Planit të Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Kamenicës, 2024-2028, miratuar nga KK Kamenicë	

Të nderuar

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës(në tekstin e mëtejshëm MMPHI), në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuar me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesën e MAPL për shqyrtimin të detyrueshëm të ligjshmërisë së aktit ashtu siç parashihet me Nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale,si vijon:

- Vendimi Nr.21038 për miratimin e Planit të Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028,
- Miratuar me datën 21.06.2024, KK Kamenicë
- Dërguar për shqyrtim në MAPL 02.07.2024

MMPHI-ja pas shqyrtimit të aktit të Komunës dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 dhe nenit 7, paragrafi 4 pika 10, neni 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës :

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimit Nr.21038 për miratimin e Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Kamenicës , 21024-2028

Arsyetim

Me datë 05.07. 2024 MMPHI kemi pranuar dhe shqyrtuar Kërkesën e MAPL-së Nr.020-435, date: 02.07.2024 për shqyrtim të detyrueshëm të Ligjshmërisë së Vendimi Nr.21038 të KK Kamenicë për miratimin e Planit të Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Kamenicës, 2024-2028, me qenë se ekzistojnë arsyeje objektive , është bazuar edhe në disa ligje të shfuqizuara, aktin e kthejmë në Rishqyrtim.

Në faqen 4 të Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Kamenicës, është cekur se Plani është i bazuar në legjislacionin në fuqi, po e citojë:,, Plani Lakol i Transportit Rrugor i Komunës së Kamenicës, është bazuar në Kornizën ligjore në fuqi në Kosovë.

Disa prej Ligjeve ku është i bazuar Plan i Komunës së Kamenicës janë të shfuqizuar dhe atë si vijon:

Ligji Nr.2004/1 për Transportin Rrugor është i shfuqizuar me Ligjin .04/L-179 për Transportin Rrugor, Neni 86 përcakton si në vijim:

Neni 86 (Shfuqizimi)

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për Transportin Rrugor Nr.2004/1 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor Nr.02-L/12;

Ligji Nr.02/L-70 për Siguri në Komunikacionin Rrugor , është shfuqizuar pjesërisht me Ligjin 05/L-64 për Patent Shofer dhe Ligjin 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ndërsa në tërësi ky Ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr.05/L-132 për Automjete, Neni 126 përcakton si në vijim,

Neni 126 (Shfuqizimi i ligjit)

Më hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 02/L-70 për Siguri në Trafikun Rrugor dhe të gjitha Udhëzimet Administrative që kanë dalë nga ky ligj;

Ndrra, Ligji Nr 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor , ka shfuqizuar Ligjin 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, që është cekur më lartë.

Po ashtu është bazuar edhe në Ligji për Mbrotjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160, i cili është i shfuqizuar me Ligjin Nr.08/L-025 për Mbrotjen e Ajrit nga Ndotja ;


Prandaj , duker marrë parasysh që ky Plan është i bazuar edhe në Ligje të shfuqizuar, DL nuk e ka përcjellë te departamentet e linjës për marrjen e vlerësimit profesional siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

MMPHI, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarë do sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nënvlerësuar për 42,689€.
- B1 Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë 128,451€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga kjo shumë 102,651€ ishin pagesa të ekzekutuara nga thesari për vendime gjyqësore/përmbarimore për të paguara për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria e mallra dhe shërbime, si dhe 25,800€ janë shpenzuar nga kategoria mallra dhe shërbime, ndërsa për nga natyra i takon Subvencioneve dhe transfereve.
- C1 Mos regjistrimi i plotë i pasurive jo financiare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B2 Angazhimi i stafit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe kontrata për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës.
- A2 Kontraktimi me OE për projektin që mund të kryhej nga institucioni publik (Instituti Bujqësor i Kosovës).
- A3 Komuna nuk ka arritur të përmbush detyrimin ligjor të verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme, duke verifikuar vetëm 7.2% të tyre në vitin 2023.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kamenicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kamenicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kamenicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kamenicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PFV-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, detyrimeve kontingjente, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve si dhe menaxhimin e projekteve kapitale të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 8 rekomandime, prej tyre 4 janë rekomandime të reja, 3 të përsëritura dhe 1 pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontingjente

Gjetja	Bazuar në nenin 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore përcaktohet se: "Organizatave buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente". Nga analiza e PVF-ve kemi vërejtur se raportimi i detyrimeve kontingjente në PVF nuk ishte i plotë dhe i saktë, pasi që ishin nënvlërësuar për 42,689€. Në një rast kemi vërejtur se komuna nuk kishte shpalosur në PVF një detyrim kontingjent ndaj një të punësuarit në QKMF në vlerë prej 21,594€. Gjithashtu në 11 raste të tjera, vlera në regjistrin e detyrimeve kontingjente dhe shpalosur në PVF ishte gjithsejt 21,21€, ndërsa duhej të ishte 21,117€. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës.
Ndikimi	Mos shpalosja e saktë dhe e plotë e detyrimeve kontingjente ka ndikuar në nënvlërësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës.
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontingjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Përmes pagesave direkte nga Thesari, janë ekzekutuar 22 transaksione në vlerë 102,651€⁵ për pagat jubilarë dhe shujta, të cilat janë realizuar nga kategoria ekonomike mallra e shërbime. Nga këto shpenzime 59% (60,722€) janë borxh kryesor, ndërsa 41% (41,929€) janë shpenzime gjyqësore-përmbarimore dhe kamata.

Më tutje, kemi vërejtur se marrëveshja për dhënien e një donacioni nga komuna për UNDP në vlerë 25,800€, pagesa ishte kryer nga kategoria mallra dhe shërbime dhe jo nga subvencione dhe transfere. Në këto dy raste keq klasifikimi i shpenzimeve ishte në vlerë 128,451€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i mos komunikimit mes komunës dhe thesarit. Ndërsa, pagesa e donacionit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ka ndodhur si rezultat i moskuptimit të rregullave financiare që rregullojnë përdorimin e fondeve publike.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë dhe të saktë të shpenzimeve në PVF, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës më mbivlerësim/ nënvlerësim të kategorive ekonomik.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Mos regjistrimi i plotë i pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6 paragrafi 1 përcakton se: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Nga testimet tona kemi vërejtur se në sistemin e E-pasurisë ishin të regjistruara mbi 3,217 njësi të pasurive jo financiare (nën 1,000€), ndërsa bazuar në raportin e inventarizimit përmbante mbi 60,000 njësi të cilat nuk

ishin të regjistruara në E-pasuri. Këto pasuri janë kryesisht inventaret e QMF-ve dhe shkollave.

Për më tepër në raportin e SIMFK të pasurive jo financiare mbi 1,000€, kemi vërejtur regjistrimi të përgjithësuara me përshkrimin e pasurisë pa përcaktim të lokacionit si (asfaltimi i rrugëve lokale, kanalizime në qytet e fshatra, toka etj.), në rastin e tokave nuk na është ofruar një raport i vlerësimit të brendshëm për regjistrimit e 94 njësive në vlerë 43,413,511€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive në procesin e evidentimit raportimit dhe monitorimit të pasurive jo financiare nën 1,000€ në sistemin e E-pasurisë, ndërsa pasuritë mbi 1,000€ janë regjistruar në mënyrë të përgjithësuar është si pasojë e regjistrimeve totale të pagesave/projekteve e jo në njësi të veçanta të pasurive.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive nën 1,000€ në sistemin e-pasurisë, si dhe regjistrimi i përgjithësuar i pasurive mbi 1,000€, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi C1

Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet vlerësimi i pasurive jo financiare për të azhurnuar regjistrin të pasurive për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Angazhimi i stafit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe kontrata për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës

Gjetja

Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët publik, nenit 84, përcakton se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik". Përderisa neni 59 i RRUOPP ka përcaktuar qëllimin dhe procedurën e prokurimit publik lidhur Marrëveshjet për shërbime të veçanta. Përkatësisht, neni 59.1 ndër të tjera definon "shërbimet konsulente"- të cilat nënkuptojnë një shërbim të një natyre intelektuale apo konsultative, që furnizohet nga një konsulent ekspert dhe i kualifikuar në një fushë të caktuar apo profesion dhe përfshinë shërbime ku aspektet intelektuale dhe kontributet mbizotërojnë dhe tejkalojnë aspektet tjera fizike të kontratës. Po ashtu, neni 10.6 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 thotë se: "Kontrata për një detyre specifike, nuk mund të jetë me e gjatë se 120 dite brenda një (1) viti.

Komuna kishte angazhuar 32 punonjës përmes "Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV)", prej tyre tetë (8) ishin angazhuar përmes procedurave të prokurimit, ndërsa 24 me procedurë të thjeshtë të rekrutimit pa i respektuar procedurat e prokurimit publik.

Punonjësit janë angazhuar për pozita të rregullta të punës dhe jo për shërbime të veçanta apo detyra specifike, siç kërkohet me ligj.

Për më tepër në 20 raste kohëzgjatja ishte nga 5 (pesë) deri në 12 muaj, duke tejkaluar afatet e përcaktuara ligjore (120 ditë brenda vitit 2023). Kontratat ishin lidhur me personat njëjtë dhe për pozitat e njëjta dy deri tre herë. Për këta punonjës komuna në vitin 2023 kishte paguar 77,073€.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së pozitave të aprovuara të vendeve të punës më ligjin për buxhetin e RK-së.

Ndikimi

Angazhimi i stafit sipas marrëveshjeve për shërbimeve të veçanta/kontratave për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta, mund të rritë kostot e Komunës krahasuar me kostot e rekrutimit të stafit të rregullt, si dhe mund të rezultojë se staf i angazhuar të jetë jo përkatës për nevojat e komunës, duke ndikuar në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike, aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kontraktimi me OE për projektin që mund të kryhej nga institucioni publik.**Gjetja**

Udhëzimi Administrativ UA nr. 02/2012 për klasifikimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore, neni 8 paragrafi 3 përcakton se: Vlerësimi do të bëhet nga një institucion i autorizuar i MBPZHR. Po ashtu, Ligji Nr. 04/L-42 për prokurimin publik, neni 9 paragrafi 4, taksativisht normon se Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Komuna kishte nënshkruar kontratat me OE (konsorcium) në vlerë 328,781€ për projektin „Inventarizimi i tokave në Komunën e Kamenicës”. Përkundër faktit që ku projekte të kësaj natyre mund të realizohen nga MBPZHR-Instituti Bujqësor i Kosovës. Për më tepër, komuna nuk kishte bërë kërkesës zyrtare IBK-së për realizimin e këtij projekti.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së informacioneve të mjaftueshme nga zyrtaret komunal mbi detyrimet dhe përgjegjësit që autoriteti publik (IBK) ka për të siguruar kryerjen e projekteve të kësaj natyre.

Ndikimi

Mos shfrytëzimi i resurseve njerëzore dhe teknologjike të cilat i posedon IBK-ja në realizimin e projekteve të kësaj natyre dhe lidhja e kontratës me operator ekonomik privat ndikon në shfrytëzimin e paarsyeshme të fondeve buxhetore.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj para çdo aktiviteti të prokurimit që për projektet të cilat mund të kryhen nga autoritetet publike të zbatohet neni 9 paragrafi 4 i LPP-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të pronave të paluajtshme**Gjetja**

Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 2, përcaktohet se "Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet për qind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat."

Komuna në vitin 2023 për tatimin në pronë të objekteve në sistemin Protax kishte të regjistruar 15,562 objekte. Në kemi vërejtur se komuna nuk kishte arritur të bënte inspektimin (verifikimin) e 20% pronave të paluajtshme siç kërkohet nga ligji në fuqi, por kishte verifikuar vetëm 1,120 pronave të paluajtshme apo 7.2%.

Mos verifikimi i pronës ka ndodhur për shkak të mungesës të anketuesve në terren për verifikim të pronave të paluajtshme.

Ndikimi

Moskryerja e inspektimit të pronave të paluajtshme mund të rezultojë në informacion jo të plotë për gjendjen aktuale të pronave, të ardhura potencialisht më të ulëta të mbledhura në dobi të komunës, dhe gjithashtu mund të rezultojë në një ngarkesë tatimore joadekuate.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2023 ishin në vlerë 1,164,214€. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja A4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 dhe 11.4 4, përcakton se: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. UA nr. 03/20211 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1 kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.

Në raportin financiar të objekteve janë identifikuar 614 tatimpagues që nuk kanë numër personal, për të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Kjo ka ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë, ku nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.

Ndikimi Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal për tu deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të ndërmer veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 65,702,137€, pasurive jokapitale është 302,265€, si dhe e stoqeve 456€.

Çështja B3 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive

Gjetja	Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19 paragrafi 4.3 përcakton se; Krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Mangësitë në procesin e inventarizimit, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.
Ndikimi	Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.
Rekomandimi B3	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,381,899	14,327,915	13,336,901	10,854,784	10,015,180
Grante Qeveritare - Buxheti	11,425,128	12,491,393	11,969,774	9,398,161	9,238,751
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	112,956	30,611
Të bartura nga viti i kaluar	0	625,688	548,628	496,897	178,039
Të hyrat vetanake	956,771	1,084,565	720,276	768,389	531,732
Donacionet vendore	0	100,857	75,885	21,951	36,047
Donacionet e jashtme	0	25,412	22,337	56,430	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,939,269€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 1,066,265€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 625,688€, rritjes së të hyrave për 127,794€, rritjes së donacioneve të brendshme për 94,110€ dhe rritjes së donacioneve të jashtme për 25,412€.

Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final apo 13,338,485€, me një përmirësim rreth 4,5% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,381,899	14,327,915	13,336,901	10,854,784	10,015,180
Pagat dhe mëditjet	7,566,476	8,683,981	8,672,076	7,099,227	7,208,601
Mallrat dhe shërbimet	1,943,000	2,022,568	1,770,900	1,447,461	1,151,631
Komunalitë	238,000	239,096	206,760	211,246	196,826
Subvencionet dhe transferet	447,000	653,344	620,588	578,079	282,724
Investimet Kapitale	2,187,423	2,728,926	2,066,576	1,518,770	1,175,398

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,117,505€. Rritja ishte si rezultat i vendimeve të qeverisë për 1,055,900€, nga të hyrat e bartura për 51,240€, si dhe nga fondi për rimëkëmbjen ekonomike për 10,365€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 79,568€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura për 77,964€, si dhe donacionet e jashtme për 1,604€.
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte rritur për 1,096€, rritja ishte si rezultat i hyrave të bartura.
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 199,597€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura për 89,939€, si dhe prej të hyrave të tejkaluara në bazë të vendimit të komunës për 109,658€.
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 541,503€. Rritja ishte si rezultat i të hyrat e bartura për 405,449€, prej të hyrave të tejkaluara nga vendimi i kuvendit komunal për 18,136€, nga donacionet e brendshme për 94,104€, si dhe nga donacionet e jashtme për 23,813€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2023 ishin 1,164,214€ apo rreth 7% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	956,771	956,771	1,157,467	1,088,325	908,289
Të hyrat tatimore	535,046	535,046	595,993	600,370	449,995
Të hyrat jo tatimore	421,725	421,725	559,618	487,863	458,294
Të hyrat tjera	0	0	1,856	92	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar në 6 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2023, një (1) rekomandim është, dy (2) pjesërisht të zbatuara dhe për tre (3) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe këtë vit është gjendje e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistratit të pasurive jo kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar dhe prezantuar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Pasuritë jo kapitale në sistemin e E-Pasurisë është aplikuar zhvlerësimi, por regjistri ende nuk është i plotë saktë.	Pjesërisht i zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike, aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.	Edhe këtë vitë është gjendje e njejtë.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik. Po ashtu, ndryshimet e kontratave vlera e të cilave është mbi 10% të vlerës së kontratës, do të bëhen vetëm pas aplikimit të procedurave të prokurimit.	Bazuar në testet e auditimit nuk kemi hasur leshime të tilla.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Edhe në vitin aktual kemi evidentuar mangësi në procesin e inventarizimit.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Komuna ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim dhe ka bërë disa përmirësime në regjistrin e pasurive kontabël. Mirëpo edhe në vitin 2023 kemi verejtur regjistrime të përgjithesuara kapitale dhe mosregjistrim i plotë i pasurive jo financiare.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Nënvlerësimi i detyrimeve kontigjente	Fillimisht ne ju sqarojmë se nuk kemi të bëjmë me mësimdhënës, por me një të punësuar në QKMF, ndërsa padia dhe kërkesëpadia ka qenë për anulimin e aktemërimit SH.02, Nr. 23567 te datës 06.08.2019 dhe sa i përket për mos evidentimin në PVF të vlerës prej 21,954€ është se e njëjta nuk është paraqitur në padinë kryesore, por gjatë shqyrtimit gjyqësor paditësja ka zgjeruar padinë duke bërë precizimin e padisë por që gjyqtari i çështjes nuk ka aktvendim lidhur me lejimin apo moslejimin e precizimit të saj. Andaj edhe paraqitja e kësaj shume në PVF kemi konsideruar që ka qenë e panevojshme për shkak të moslejimit nga ana e gjykatës. 11 raste, vlera në regjistrin e detyrimeve kontigjente të shpalosura në PVF ishte gjithsejtë 21,21€, ndërsa duhej të ishte 21,117€. Ky gabim i përfshirjes në PVF është si rrjedhojë e një gabimi teknik pasi që shumat e pasqyruara nga tabela të marra nga Avokati i Komunës në 11 raste shumat mbi 1,000€ janë të pasqyruara me pikë (.) dhe jo me presje (,). Duke parë që ky gabim është i paqëllimshëm kërkojmë që të mirret parasysh në përgatitjen e raportit final të opinionit lidhur me PVF-të të vitit 2023.	Është bërë përmirësimi nga mësimdhënësi në një të punësuar në QKMF ndërsa komuna për pjesën tjetër nuk ka ofruar argumente për të modifikuar gjetjen. E gjetura mbetet e pandryshuar.

Keq klasifikimi i shpenzimeve	Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime ne vlere 128,451€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Nga kjo shumë 102,651€ ishin pagesa te ekzekutuara nga thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore për të paguar për pagat jubilarë dhe shujtat nga kategoria e mallra dhe shërbime. Keq klasifikimet e shpenzimeve te ekzekutuara nga thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishin për arsye se, sipas komunës këto obligime janë jashtë autoritetit dhe mundësisë për ti planifikuar për shkak të kufizimeve qe imponojnë qarkoret buxhetore 01 dhe 02 të lëshuara nga MFPT për të respektuar kufijtë buxhetor sipas kategorive ekonomike. Ne ju informojmë (dokumentojmë) se me datën 27.10.2023 kemi bere kërkesë dhe e kemi dorëzuar në formë elektronike në MF për korrigjim të shpenzimit nga kategoria për Mallra dhe shërbime në kategorinë për Paga në shumë prej 84,422€, kërkesa nuk është aprovuar nga MF edhe përkundër kërkesës nga komuna. Gjithashtu tek gjetja shuma prej 28,500€ që janë shpenzuar nga kategoria e mallra dhe shërbimeve ndërsa për nga natyra i takon subvencioneve dhe transfereve. Kjo lëndë është për përfituesin UNDP për angazhimin praktik pune për punëkërkues, ne e kemi trajtuar si blerje e mallra dhe shërbimeve, kjo lëndë ka qenë objekt i auditimit disa here edhe nga ekipet paraprake të auditimit, konkretisht kuponi 2022-126888 shuma prej 9,000€ dhe nuk është që kemi pasur ndonjë rekomandim për pagesat e ngjashme, përndryshe ne do të kishim zbatuar rekomandimin e mundshëm të adresuar nga ana juaj.	Komuna nuk ka ofruar argumente andaj e gjetja mbetet e pandryshuar.
--------------------------------------	--	--

Kontraktimi me OE për projektin që mund të kryhej nga institucioni publik.	Sipas ligjit të vetëqeverisjes lokale 03/L-40 neni 17, pika c) Komuna ka disa kompetenca lidhur me shfrytëzimin dhe zhvillimin e tokës, Ne mendojmë që kontrata për realizimin e projektit “Inventarizimi i tokave në Komunën e Kamenicës” është lidhur në mënyrë të rregullt e dëshmon edhe “Kontrata publike kornize” e vitit 2017 me numër identifikues: 203-17-3288-2-1-1 e lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe “CONSULT ENGINEERING” & GEO&LAND, më numër të protokollit, 3222, date 08.09.2017. Kjo kontratë është lidhur për shërbimin: Konsolidimi dhe Inventarizimi i Tokave Bujqësore në Republikën e Kosovës. Projekti “Inventarizimi i tokave në Komunën e Kamenicës” është realizuar pikërisht nga operatori ekonomik “GEO&LAND” si operator që i plotëson kriteret për realizimin e projekteve të kësaj natyre. Po ashtu duhet ta kemi parasysh faktin që ky projekt është i nivelit lokal-komunal dhe komuna ka ndjekur procedurat e rregullta të prokurimit. Po ashtu nga mostrat e audituara në vitin e kaluar për vitin 2022, kuponi i shpenzimit 2022-371798 për inventarizimin e tokave ka qënë objekt i auditimit, dhe ne nuk kemi pasur ndonjë rekomandim për këtë aktivitet, në të kundërtën ne do e kishim trajtuar me seriozitet më të madh këtë çështje, por me që nuk ka pasur rekomandim, ne e kemi konsideruar që është çdo gjë në rregull.	Komuna nuk ka ofruar argumente andaj e gjetja mbetet e pandryshuar.
---	---	--




LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,




Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi koment për përmbajtjen e Draft Raportit/Të bashkangjitura në shkruesën përcjellëse /
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komitetit

Kadri Rahimi

Data: 16.05.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Kjo gjetje nuk është përcaktuese/determinuese në modifikimin e opinionit të auditimit.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.